



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXVIII-të (njëzetetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 03 dhjetor 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 09;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkolli, kurse mungoi, z.Arbnor Fazliu, kurse mungoi, znj.Shkurte Sejdiu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Ahmet Ahmeti-Njësia për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ në Komunën e Podujevës; Arbresha Bashota-zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Zita Rasztik përfaqësuese nga KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit prezent në mbledhje, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06 nëntor 2024

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi,

Njëzëri me 7 vota Për nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06 nëntor 2024.

2. Informatë e Njësitit për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës rreth fushatës një mujore për vetëdijesimin kundër trafikimit me qenie njerëzore.

z.Ahmet Ahmeti - NJDNJ në Komunën e Podujevës, e paraqiti Informatën në fjalë, theksoi, faleminderit të nderuar për mundësinë e dhënë që të japim këtë informatë. Të nderuar anëtarë të Komitetit dhe ju të pranishëm për interesimin e juaj për një Informatë nga Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Podujevës e funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës.

NJDNJ në kuadër të punëve dhe detyrave merr pjesë në fushata të ndryshme siç ishte tani së fundmi fushata një mujore nga 18 tetori 2024 deri më 18 nëntor 2024 kundër trafikimit me qenie njerëzore e që në kuadër të kësaj ne si Njësit kemi bërë promovimin e kësaj fushate ku kryesisht kemi kryesuar këtë aktivitet dhe pjesëmarrësit tjerë kanë qenë edhe akterë tjerë të ndryshëm të fushave përkatëse në këtë fushat e cila organizohet nga Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht nga Koordinatori Nacional kundër trafikimit me njerëz.

Pa dyshim se kjo është një prej fushatave që duhet t'i përkushtohemi me një vëmendje të veçantë, edhe në Komunën tonë kemi bërë edhe përvojë sepse është një traditë tash më e këtij organizmi ngase siç e dim trafikimi me qenie njerëzore paraqet një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut pasi që inkorporohet pjesa tjetër e detyrimeve, mashtrimeve të individëve sidomos tani në kohën internetit ku mundësitë janë më të mëdha të bien prerje e këtij fenomeni.

Po ashtu rreth kësaj dukurie kemi bashkëpunim të ngushtë edhe me Stacionin e policisë në Podujevë edhe pse këtë herë kemi dalë vetëm me Qendrën për Punë Sociale në kuadër të Komunës së Podujevës.

Gjithashtu ekzistojnë edhe mekanizma tjerë siç është Njësia policore përkatëse nëpër shkolla në kuadër të vetëdijesimeve të ndryshme kundër delikuencës e që ne këtë herë kemi përzgjedhur 4 shkolla, përkatësisht në shkollat e fshatit Lupç, Majac, shkolla “Shefki Kuleta”, pra kryesisht jemi përcaktuar në shkollat rurale pasi që aktivitet tjera të mëparshme kryesisht kanë qenë në zona tjera në qytet dhe fshatra tjera përreth.

Qëllimi ka qenë bashkëbisedimi me nxënësit rreth mënyrës se si ata e perceptojnë këtë fenomen dhe ne pastaj bashkërisht me QPS-në-Drejtoreshën e këtij organe dhe me zyrtaren për Barazi Gjinore në Komunën e Podujevës si dhe me psikologët e atyre shkollave dhe kujdestarët e klasave kemi treguar format e mundshme se si shfaqet kjo dukuri si dhe rreth mbrojtjes nga kjo dukuri duke filluar nga vetja e pastaj për fëmijët tanë përkatësisht nxënësit e shkollave.

Mungesat e nxënësve në shkolla mund të jetë një prej potencialeve kryesore që mund të biejnë pre e formave të ndryshme të mashtrimeve e pastaj këtu më e keqja mund të vie deri tek prostitucione të ndryshme që është një prej formave të mashtrimit si mënyrë e shfaqjes së kësaj dukurie.

Meqë jemi tek kjo fushatë, do të thotë ka edhe fushata tjera të ndërgjegjësimit që ne si Njësitë ndërmarrim aktivitete të ndryshme siç është tani që ka filluar fushata kundër dhunës në familje e cila zhvillohet për 16 ditë, mandej ka qenë edhe i ashtuquajturi Muaji i Tetorit që ka të bëjë me aktivitete për inkooprimin e personave me nevoja të veçanta në jetën institucionale dhe mundësit të tyre, për çka ka qenë një aktivitet dhe fushatë e tyre që është udhëhequr nga NJDNJ. Pra i nderuar Kryesues i këtij Komiteti, këto ishin disa nga theksimet e aktiviteteve të cekura që i paraprinë fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore por edhe aktivitete tjera që i potencova, por nëse ndokush ka diçka për të shtruar lirshëm urdhëroni dhe mund të diskutojmë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin për informatën e dhënë, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Përndryshe ne jemi në dijeni se kemi qenë në një trajnim rreth kësaj çështje dhe shumë mirë që ndodhin aktivitete të tilla në kundër trafikimit me qenie njerëzore në Komunën e Podujevës e sidomos në lagjet ku jetojnë komunitete jo shumicë e që për momentin nuk kemi raste të ndonjë dhune apo trafikimi me njerëz, pra deri tani mirë qëndrojmë në këtë aspekt por nuk do të thotë që nuk duhet të kemi kujdes sepse mund të ndodhin raste të tilla ngase janë gjëra të pritshme thuajse, prandaj edhe njëherë ju falënderoj për këtë informatë dhe pres diskutim.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përshëndesim fushatën përkatëse që është mbajtur dhe njëkohësisht inkurajojmë që të mbahen fushata të ngjashme edhe ndaj largimit dhe parandalimit të përdorimit të substancave narkotike që janë tani më shumë evidente në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë edhe njëherë urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS për gjendjen e banimit, strehimit të Komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

znj.Arbesha Bashota, zyrtare në DSHMS-Podujevë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj Informate, ndër të tjera theksoi, lidhur me çështjen e banimit në Komunën e Podujevës ne gjithëherë kemi kërkesa prej familjeve të komuniteteve jo shumicë për strehim dhe përmirësim të kushteve të banimit, gjithashtu kemi kërkesa edhe për renovim të shtëpive, mirëpo në mungesë të buxhetit ne vetëm i vizitojmë dhe i përfshijmë në listën e pritjes në rast të ofrimit të ndonjë donatori të mundshëm që ne pastaj t'i kemi të gatshme familjet në nevojë për t'ju ofruar ndihmë dhe t'i vizitojmë me qëllim të mundësisë së ndërtimit të shtëpive të tyre mirëpo problem tjetër është edhe prona ku shumica e atyre që aplikojnë nuk kanë pronë, ose e kanë pronën shumë të vogël ku nuk ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një shtëpie, pastaj shumica e atyre që aplikojnë dëshirojnë edhe ndërtimin e shtëpisë duke shtuar edhe një kat apo shtim të dhomave gjë që kjo pastaj është paksa problem për donatorët për të pasë bashkëpunim dhe koordinim mes tyre ngase donatorët nëse dëshirojnë e bëjnë ndërtimin e shtëpive nga fillimi.

Ne në kuadër të Marrëveshjes që kemi me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, tash së fundmi nga 5 familjet që i kemi përzgjedh njëra prej tyre është nga komuniteti jo shumicë dhe tani shtëpia i është ndërtuar dhe vetëm pritet mobilimi i saj për të hyrë në të, vlen të theksohet e Komuna ka participuar me 10,000.00 €.

Pastaj Komuna ka bërë renovimin e shtëpisë së një familje të komunitetit jo shumicë në rrugën “Xhafer Meta”, bëhet fjalë për familjen e Ahmet Sejdiut të cilit i'a kemi rregulluar katin I, rrymën, ujin, kanalizimin, derën e hyrjes, dyshemenë dhe e kemi mobiluar.

Gjithashtu në lagjen e re “Shqiptarët për Shqiptarë”, tek renovimi kemi vazhduar kontratën edhe për një familje që është nga komuniteti jo shumicë që jeton në atë lagje, familjet tjera i kemi në listë të pritjes ashtu siç janë të gjitha familjet që në rast të ofrimit të ndonjë donatori të jemi të gatshëm të participojmë për ndërtim ose renovim të shtëpive.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju falënderoj për informatën e dhënë dhe ju përgëzoj për ndërtimin e shtëpisë së re që përmendet e që e cila është në proces të mobilimit.

Gjithashtu kam pyetje për ju se a keni ndonjë statistikë për numrin e atyre familjeve të komunitetit jo shumicë që janë në pritje për ndërtimin, renovimin apo zgjerimin e shtëpive të tyre, pra a keni ndonjë statistikë apo sa është numri i tyre.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS-Podujevë, në këtë vit kemi 15 kërkesa të komuniteteve jo shumicë por që shumica prej tyre janë për dyer, dritare, përmirësim të kushteve të banimit, pastaj 2 kërkesa kemi për ndërtim të shtëpisë e të cilat i kemi futur në listë të pritjes për ndonjë donatorë të mundshëm apo nëse rast të ndonjë Marrëveshje do të shqyrtohen mundësitë për përfshirjen e tyre në ndërtimin shtëpive pasi që i kemi vizituar ato me shoqatat e caktuara ku bëhet fjalë për një rast në rrugën “Xhafer Meta” dhe një në rrugën “Ali Ajeti”.
Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sërish ju falënderoj për interesimin e juaj sa i përket çështjes së banimit, strehimit dhe ndihmës së komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, fillimisht falënderoj të pranishmit këtu në këtë mbledhje duke përfshirë edhe koordinatorin e NJDNJ i cili na sqaroi paraprakisht dhe na dha informata të nevojshme rreth çështjes përkatëse, po ashtu edhe për zyrtaren parafolëse të DSHMS e cila merret me çështjen e strehimit dhe banimit të komuniteteve e që është pika më e ndjeshme nëse mund ta quaj.

Siç jeni në dijeni ne në bashkëpunim me koordinatorin e NJDNJ dhe me ju i nderuar Kryesues i kemi vizituar të gjitha familjet e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, qoftë në Podujevë që janë dy Lagjet më të mëdha që janë në rrugët “Xhafer Meta” dhe “Ali Ajeti”, mandej në fshatrat Batllavë dhe Orllan dhe ajo që u cek nga parafolësja është shumë me të drejtë sepse shumë familje kanë probleme me mungesë të pronave. Ne po ashtu jemi në dijeni se janë shpallë disa konkurse nga Ministria e Administrimit të Pushtet Lokal-MAPL, nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, por për ne si Komunë ka qenë problematika kryesore për ato kërkesa sepse çështja kryesore ka qenë prona dhe shumë njerëz që kanë nevojë e që është nevojë imediate për punësim dhe për banim pika këto shumë të ndjeshme, nuk kanë mund ta rregullojnë dokumentacionin edhe pse ne si Komunë në bashkëpunim edhe me zyrtaren e DSHMS-së që është prezentë këtu për çështje të strehimit dhe banimit nuk kemi mundur t’iu ndihmojmë në kompletimin e dokumentacionit edhe përkundër insistimit tonë që përmes noterit të bëjmë një autorizim, e që lidhur me këtë edhe shumë prej neve nuk i kemi pronat tona në emrin tonë personal sepse ato mund të jenë në emër të babës, gjyshit, agjës ose stërgjyshit, andaj kjo ka qenë paska pengesa kryesore.

Kërkesat më të mëdha në Komunën e Podujevës kanë qenë për renovim sepse janë 46 familje të cilat kanë nevojë për renovim të shtëpive, pastaj janë 6 familje që kanë shumë nevojë për ndërtimin shtëpive por që 3 prej tyre nuk kanë prona, pra problematikë e kanë pronën sepse nuk i kanë legale dhe me dokumentacion, po ashtu ka pasë kërkesa edhe për sanitari e që edhe kjo çështje është e djeshme sepse janë 38 familje et cilat kanë nevojë për teknikë dhe të ngjashme.

Normale që në Komunën e Podujevës duhet ta pranojmë realitetin se këtë vit tek çështja e strehimit dhe banimit, renovimit dhe rindërtimit dhe kërkesave tjera për sanitari kanë qenë 92 familje të komuniteteve jo shumicë të cilat kanë nevojë.

Sa për informimin e juaj po ju them se tash së voni me inicimin e Drejtorisë së Inspeksionit, përfituesi i ndërtimit të shtëpisë që është familja e Shiqiria Bajramit nga komuniteti ashkali në rrugën “Xhafer Meta” e cila pronën e ka të vetën dhe është me gjendje të rëndë ekonomike e cila nuk ka pasë mundësi ta bëjë rrënimin vetë, prandaj Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim edhe

z.Ahmet Ahmetin i cili e kryen e he detyrën e shefit të Inspeksionit ka intervenuar aty kështu që për këtë duhet falënderuar Komuna e Podujevës edhe Drejtoria e Urbanizmit e cila ka dhënë pëlqimin që ajo shtëpi të rrënohet, diku në vlerë rreth 2000.00€, dhe tani pritet ndërtimi i asaj shtëpie të asaj familje si përfituese nga Ministria për Komunitete dhe Kthim në cilësinë e financueses, prandaj kjo ishte vetës sa për informacion që është duke ndodh tani.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin për informatat e dhëna. Unë e di se ka qenë një punë e palodhshme atë ditë ku kemi vizuar të gjitha familjet e komuniteteve jo shumicë në territorin e Komunës së Podujevës për çka kemi bërë edhe foto dhe ato gjenden në arkivat dhe dokumentacionet e juaja në mënyrë që për çdo rast varësisht mundësive të intervenohet në ato shtëpi, prandaj edhe njëherë ju falënderoj shumë për punën e juaj.

Në bazë të statistikave që i potencuat vërtetë numri është i madh i atyre që kanë nevojë, por në qoftë se ka mundësi qoftë prej ndonjë donatori apo ndonjë forme tjetër sepse për shkak të buxhetit të vogël të Komunës nuk mund të mbërrihen ato investime për ato kërkesa, apo nëse ekziston mundësia e dërgimit të ndonjë kërkesë në MAPL për ndihmë financiare me qëllim të intervenimit në ato shtëpi ngase për ndërtim të shtëpive nuk qenkan shumë sipas asaj që u cekë nga parafolësi.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

4. Informatë e Entit të Punësimit / Zyra e Punësimit rreth evidentimit të kërkesave për punë dhe trajnimeve për treg pune nga radhët e Komuniteteve jo shumicë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, këtë pikë të rendit të ditës e kemi paraparë me qëllim që të informohemi rreth kësaj çështje edhe ne si Komitet dhe unë personalisht e kam dërguar si kërkesë në këtë institucion për të ardhur në këtë mbledhje dhe të informohemi, mirëpo sa po vërej unë nuk ka ardhur askush nga Enti i Punësimit për të na informuar.

Përndryshe Drejtoresha e Entit të Punësimit më ka kontaktuar në telefon dhe ka kërkuar nga unë që t'i sjellë dy emra me shkollim të mesëm nga komuniteti jo shumicë për t'i punësuar, unë i kam dërguar dy femra të cilat janë lajmëruar në atë institucion e që tani sa kam informata janë duke e ndjekur një trajnim paraprakisht dhe sa do të mund ta gjejnë vetën pastaj për tu punësuar nuk mund të them asgjë.

Gjithashtu mund të them se tani së fundmi komuniteti jo shumicë është vetëdijësuar dhe po largohet nga skemat sociale ngase deri tani mund të them se arsyeja kryesore e mos punësimit të komunitetit jo shumicë ka qenë ndihma sociale, mirëpo tani sigurisht pjesa më e madhe e kanë parë që nuk jetohet vetëm prej ndihmave sociale kështu që një numër i tyre ka filluar të punësohet, mirëpo Drejtoresha e Entit të Punësimit nuk është këtu prezentë për të na dhënë informata rreth çështjes në fjalë.

z.Florent Hasani, theksoi, kërkoj ndonjë statistikë për këtë vit sa ka mund të shkoj numri i të punësuarve nga komuniteti jo shumicë, nëse veç ndokush mund të na informoj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa unë kam informatë, në lagjen ku jetoj unë në rr."Ali Ajeti" deri tani janë punësuar 13 persona në një fabrikë të armaturës në Prishtinë ku sipas asaj që jam në dijeni puna ish vetë kompjuterike dhe ishte e nevojshme të kenë shkollim për të mund të punuar me ato makineri në atë fabrikë, kështu sa jam në dijeni ata perona janë adaptuar shumë mirë në atë punë, dhe tani janë bërë 3 muaj nga punësimi në atë fabrikë dhe janë të kënaqur me

punën, kontratën e kan deri në fund të vitit por në bazë të bisedave me ata perona jam informuar se me shumë gjasë atyre do t'ju vazhdohet kontrata e punës.

Po ashtu kemi edhe të punësuar në KRM "Pastrimi", sa jam i informuar nga z.Liman Zeqiri numri i tyre është 14, e që 9 prej tyre janë me kontratë deri në fund të muajit janar 2025, si dhe po ashtu pritet të punësohen edhe dy të tjerë që i ceka më herët, kështu që kemi të bëjmë me një numër bukur të madh të personave të komuniteteve jo shumicë që janë punësuar he që pritet të punësohen në të ardhmen.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, për këtë temë sigurisht jeni në dijeni se informatat i kam dhënë edhe në mbledhjen e kaluar, megjithatë do t'i jap edhe sot në pika të shkurtra.

Normale që ne si ZKKK kemi koordinim të vazhdueshëm me Entin e Punësimit, me theks rreth çështjes së ri-atdhesimit të atyre peronave që kthehen nga vendet e jashtme dhe në këtë aspekt e kemi edhe detyrë që t'i mbajmë disa evidenca dhe statistika mirëpo meqë ato statistika dhe evidenca evoluojnë vazhdimisht dhe nuk mund të kemi saktësisht pa qenë dikush nga Enti i Punësimit sepse ata janë kompetent për këtë çështje.

Megjithatë unë ato informata që i kam po i potencoj se nga komuniteti jo shumicë në këto dy vitet e fundit janë rreth 21 perona të cilët kanë kërkuar punë. Enti i Punësimit mban lidhje edhe me organizata të ndryshme por më shumë edhe me sektorin privat e që pastaj është edhe Qendra e trajnimeve e cila dërgon të lajmëruarit për trajnime të ndryshme qoftë ata persona që kthehen qoftë ata që kërkojnë punë, ai institucion ka për obligim që t'i dërgojnë në Qendrën e Aftësimit Profesional e cila gjendet në Prishtinë me qëllim të aftësimit të tyre për punë, prandaj e potencova se nuk mund të them numër të sakt ngase numri i tyre ndryshon vazhdimisht qoftë brenda vitit apo edhe brenda jave. Pra kjo është ajo mirëpo mirë do të ishte të ishin prezent zyrtar nga Enti i Punësimit dhe të na japin informata konkrete rreth kësaj çështje por megjithatë ne jemi të detyruar disa informacione t'i marrim nga ata dhe që i paraqita në këtë mbledhje por edhe në mbledhjen e kaluar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin për këto statistika të dhëna, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike ë rendit të ditës, nëse jo atëherë e mund ta konsiderojmë të përfunduar.

5. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, po besoj që paraprakisht ne i përfshimë në diskutime e mëparshme pothuajse të gjitha çështjet kryesore që patëm në këtë mbledhje, mirëpo nëse ndokush ka diçka në këtë pikë urdhëroni.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, meqë tani është edhe fundi i vitit dhe kemi edhe festat e fund vitit shfrytëzoj rastin që t'ju uroj festat e fund vitit duke ju dëshiruar të gjithëve begati dhe lumturi në familjet e juaja si dhe të shprehë mirënjohje për kontributin në punë në këtë vit që po lëm pas, që kemi pasë me ato mundësitë tona që kemi pasë dhe duke falënderuar edhe Komunën e Podujevës me të gjitha departamentet e saja sepse kanë qenë të gatshme në shërbim të qytetarëve gjë të cilën e kanë dëshmuar edhe me fakte në praktikë, mirëpo duke falënderuar me theks ato Drejtori me të cilat ne enkas punojmë me to e që janë paska më të ndjeshme tek komunitetet jo shumicë e që janë Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punës Sociale, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si dhe gjithë sektorët tjerë që kanë

dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për të gjithë qytetarët e me theks të veçantë për komunitetet jo shumicë gjë e cila është një pasqyrë e mirë e Komunes së Podujevës dhe mendoj se do të vazhdojmë edhe vitet në vijim dhe kjo është ajo që gjithherë ju falënderoj për bashkëpunimin e juaj i nderuar Kryesues i këtij Komiteti dhe me të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete, dhe po ashtu edhe me KFOR, Policinë e Kosovës, OSBE-në dhe gjitha Organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare që çdo herë kanë qenë në mbështetje tonë duke na ndihmuar dhe përkrahin, andaj vetëm dua t'i përsëris që ta kenë një vit të mbarë duke potencuar se ky vit që po lëm pas ka qenë vit i sukseseve, andaj ju faleminderit shumë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe njëherë falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri për të gjitha këto që i potencoj. Unë tani nuk kam as çfarë të them sepse pothuajse të gjitha i përmbledhi parafolësi, andaj vetëm ju uroj që në vitin e ardhshëm të kemi suksese.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 09:35

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0077152/24
Podujevë, 03 dhjetor 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**